

URDHËR
Nr. 906, datë 3.9.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE MBI KËRKESAT SPECIFIKE TË
TRAJNIMIT PËR STAFIN, PËR KRYERJEN E KONTROLLEVE FIZIKE TË
CAKTUARA NË PIKAT E KONTROLLIT KUFITAR¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 104, pika 6, të ligjit nr. 61, datë 30.6.2026, “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, të rregullimeve për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe për shëndetin e bimëve e të produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky urdhër përcakton rregullat për caktimin e kërkesave specifike për trajnim, siç përcaktohet në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 61, datë 30.6.2026, “Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, të rregullimeve për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe për shëndetin e bimëve e të produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë”, këtu e në vijim ligji për kontrollet zyrtare, për stafin, i cili kryen kontrolle fizike në Pikat e Kontrollit Kufitar (PKK), dhe që:

a) asiston një veteriner zyrtar në kryerjen e kontrolleve fizike në kafshët e gjalla, përveç kafshëve ujore ose në mish dhe të brendshmet e ngrënëshme të mishit;

b) kryen kontrolle fizike në kafshët ujore, në produktet me origjinë shtazore, përveç atyre të parashikuara në shkronjën “a” të kësaj pike, në produktet germinale ose në nënproduktet shtazore që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor.

2. Ky urdhër nuk zbatohet për veterinerët zyrtarë dhe për inspektorët zyrtarë të shëndetit të bimëve.

Neni 2

Detyrimet e përgjithshme të autoritetit kompetent në lidhje me trajnimin

1. Stafi i përcaktuar shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 1 të këtij urdhri asiston veterinerin zyrtar në kryerjen e kontrolleve fizike ose kryejnë kontrolle fizike, në përputhje me pikën 2, të nenit 49, të ligjit për kontrollet zyrtare, vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses një program trajnimi që plotëson kërkesat e nenit 3 të këtij urdhri.

2. Institucioni përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar në PKK, që është autoriteti kompetent i kontrollit në PKK, këtu e në vijim autoriteti kompetent, zhvillon dhe organizon programin e trajnimit për të siguruar që kontrollet fizike të parashikuara në nenin 1 të këtij urdhri të kryhen me nivelin e nevojshëm të kompetencës teknike dhe ekspertizës. Programi i trajnimit është teorik dhe praktik.

3. Autoriteti kompetent mban regjistra të programit të trajnimit në formë të shkruar ose elektronike për çdo individ, duke përfshirë datat, kohëzgjatjen, përshkrimin e programit, dhe kur është e nevojshme, certifikatat që vërtetojnë përfundimin me sukses të programit të trajnimit nga

¹ Ky urdhër është përafëruar plotësisht me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2019/1081, të datës 8 mars 2019, që përcakton rregullat mbi kërkesat specifike të trajnimit për stafin, për kryerjen e kontrolleve fizike të caktuara në Pikat e Kontrollit Kufitar.

stafi. Autoriteti kompetent siguron që çdo pikë kontrolli kufitare brenda vendit, të ketë akses në regjistrat e trajnimit që mbahen në formë të shkruar ose elektronike.

Neni 3

Kërkesat lidhur me përmbajtjen e programit të trajnimit

1. Përmbajtja e programit të trajnimit përcaktohet në përputhje me kafshët dhe mallrat për të cilat janë autorizuar Pikat e Kontrollit Kufitar, si dhe me detyrat dhe përgjegjësitë që i janë ngarkuar stafit.

2. Programi i trajnimit përfshin temat e mëposhtme:

a) legjislacionin në fuqi në lidhje me hyrjen në Republikën e Shqipërisë të kafshëve dhe mallrave, përfshirë procedurat dhe veprimtaritë që duhet të kryhen gjatë dhe pas kontrolleve fizike;

b) parimet e përgjithshme të kontrollit të kafshëve;

c) vlerësimin e aftësisë së kafshëve për udhëtim;

ç) aspektet praktike të trajtimit të kafshëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë masat për parandalimin ose reduktimin e vonësive në Pikat e Kontrollit Kufitar, dhe kur është e nevojshme, ushqyerjen, furnizimin me ujë, shkarkimin dhe akomodimin e kafshëve;

d) kontrollin shqisor të mallrave;

dh) kontrollin e mjeteve të transportit dhe kushteve të transportit, përfshirë menaxhimin e mallrave të ndjeshme ndaj temperaturës (zinxhiri ftohtës) dhe transportin e kafshëve;

e) identifikimin e specieve të kafshëve, përfshirë, sipas rastit, identifikimin e specieve aliene invazive, të cilat janë specie të huaja dhe për të cilat është konstatuar se futja ose përhapja e tyre kërcënon ose ndikon negativisht mbi biodiversitetin dhe shërbimet ekosistemetike të lidhura, të futura përmes kafshëve dhe mallrave;

ë) procedurat e kontrollit, të lidhura me:

i. përdorimin e pajisjeve;

ii. zbatimin e planeve të monitorimit;

iii. procedurat e marrjes së mostrave dhe analizat laboratorike në lidhje me kafshët dhe aspektet e shëndetit të kafshëve dhe të shëndetit publik;

f) metodat për interpretimin e rezultateve të testeve laboratorike dhe vendimmarrjen përkatëse, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

g) vlerësimin e riskut, përfshirë mbledhjen e të dhënave, në lidhje me shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik, me qëllim kryerjen e kontrolleve fizike të orientuara në mënyrë të përshtatshme;

gj) parandalimin e kontaminimit të kryqëzuar dhe përputhshmërinë me standardet përkatëse të biosigurisë;

h) kërkesat e etiketimit për mallrat e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 47 të ligjit për kontrollet zyrtare;

i) metodat hetimore dhe teknikat e kontrollit për zbulimin e praktikave mashtruese ose të padrejta në tregti.

Neni 4

Aktivitetet dhe programet e trajnimit për shkëmbimin e stafit, të organizuara në përputhje me nenin 103 të ligjit për kontrollet zyrtare

Me përjashtim të pikës 1, të nenit 2 të këtij urdhri, stafi i përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 1, mund të asistojë veterinerin zyrtar në kryerjen e kontrolleve fizike ose të kryejë kontrolle fizike në përputhje me pikën 2, të nenit 49 të ligjit për kontrollet zyrtare, nëse është trajnuar në kuadër të veprimtarive të trajnimit ose programeve për shkëmbimin e stafit, të organizuara në përputhje me nenin 103 të ligjit për kontrollet zyrtare, me kusht që këto veprimtari ose programe të përfshijnë përmbajtjen dhe temat e programit të trajnimit të përmendur në pikën 2, të nenit 3 të këtij urdhri.

Neni 5
Dispozita të fundit

1. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe institucioni përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar në Pikat e Kontrollit Kufitar për zbatimin e këtij urdhri.

2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 gusht 2027.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla